

KORNELJA SIMA

VËZHGIME MBI EMËRTIMET E REJA TË GRAVE SIPAS PROFESIONIT NË FUSHËN E PRODHIMIT INDUSTRIAL PAS ÇLIRIMIT

Problemi i emërtimit të njerëzve sipas profesionit që ushtrojnë dhe detyrës që kanë, duke qenë një çështje e veçantë e leksikut dhe e fjalëformimit, deri më sot, nuk është trajtuar më vete në ndonjë studim.¹

Megjithatë në punime të ndryshme për leksikologjinë, fjalëformimin dhe gramatikën e shqipes, krahas problemeve të tjera themelore, janë prekur aty-këtu edhe emra që shënojnë njeriun sipas profesionit.²

Edhe në fjalorët e ndryshëm të botuar para dhe pas çlirimit janë pasqyruar emërtime të tilla, por gjithnjë në masën që përputhej me natyrën e vetë fjalorëve, të cilët kanë qenë kryesisht fjalorë dygjuhësh.

Po të vështrojmë pasurinë e leksikut të gjuhës së sotme shqipe, do të vërejmë se emërtimet e njerëzve sipas profesionit përbëjnë një shtresë leksikore të gjallë të gjuhës, që pasurohet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme.

Arësyeja e kësaj gjallërije dhe e këtij zhvillimi, duhet kërkuar në radhë të parë në ndryshimet e rëndësishme që ndodhën në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore tek ne pas çlirimit, si rezultat i revolucionit popullor. Këto ndryshime sollën zhdukjen e pronës private mbi mjetet e prodhimit, zhvillimin e prodhimit të gjerë shoqëror mbi pronën e përbashkët, zhvillimin e degëve të rëndësishme të ekonomisë, të shkencës, të kulturës, si dhe pjesëmarrjen e gjerë të forcave të punës në prodhim.

Kushtet e reja sociale, shtruan përpara gjuhës kërkesa të reja. Këto kërkesa leksiku i përmbushi: me zhvillimin e shumë kategorive të reja leksiko-semantike që shënonin nocione nga sfera të ndryshme të jetës, me daljen në dritë të pasurive leksikore të panjohura më parë, me pasurimin e mëtejshëm me fjalë e shprehje të reja, si dhe me ndryshime në semantikën e fjalëve.

Në kuadrin e këtyre ndryshimeve që ndodhën në leksik, për-

1) Bën përjashtim këtu kumtesa e V. Milkani, *Mbi prirjen e zhvillimit të emërtimit të njerëzve sipas profesionit*, mbahtur në sesionin shkencor kushtuar 25-vjetorit të çlirimit të atdheut, e cila nuk është botuar ende.

2) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 18, 25, 27, 28, 31, 38, 107; A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, «Buletin i shkencave shoqërore», Tiranë 1955, nr. 4, f. 36-37.

fshihen edhe ato që ndodhën në shtresën e emrave të njerëzve sipas profesionit, që u dukën, si në rritjen e tyre sasimore ashtu edhe në ndryshimet e kuptimit të shumë fjalëve të trashëguara nga e kaluara.

Prandaj kjo shtresë leksikore, dhe proceset që kanë ngjarë dhe ngjasin në të, presin trajtimin e vet në veçanti nga ana leksikologjike dhe e fjalëformimit.

Në këtë shtresë marrin rëndësi në mënyrë të veçantë emërtimet e grave sipas profesionit, pasi në këta emra vërehen edhe më qartë tiparet kryesore të këtyre ndryshimeve si në sasi ashtu edhe në cilësi.

Në këtë punim do të kufizohemi tek emërtimet e reja të grave sipas profesionit në fushën e prodhimit artizanal-industrial dhe të drejtimit të tij.

Qëllimi i këtij trajtimi është që të tregohet pasuria leksikore në këtë fushë, të zbulohen shkaqet e zhvillimit dhe rrugët e pasurimit të saj, të përcaktohen tipat kryesorë dhe më produktivë, për të gjetur mbi këtë bazë prirjet e zhvillimit të mëtejshëm, si dhe rrugët për ngulitjen e termave të formuara nga brumi i shqipes dhe sipas modeleve të saj. Për të nxjerrë në pah më mirë veçoritë e emërtimeve të grave sipas profesionit në këtë fushë, e ndjejmë të nevojshme t'i krahasojmë këto me emërtimet që kemi në vitet e paraçlirimit, si në planin gjuhësor, ashtu edhe në planin e kushteve ekonomiko-shoqërore, që kanë përcaktuar fatin e kësaj shtrese të leksikut të shqipes.

*

Kushtet e rënda ekonomiko-shoqërore dhe politike në të cilat ndodhej vendi ynë para çlirimit, marrëdhënjet e vjetra në prodhim dhe mbi këtë bazë zhvillimi i paktë i forcave prodhuese, nuk lejonin pjesëmarrjen e gjerë të njerëzve në prodhimin shoqëror. Prodhimi ngushtohet në disa degë të caktuara dhe mbështetej në një pronësi private të copëtuar; kjo është arsyeja që edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit që gjejmë në këtë periudhë, janë të kufizuara për degë të rëndësishme të ekonomisë, siç është prodhimi industrial, si dhe për sferat e jetës kulturalo-artistike dhe shoqërore në përgjithësi.

Vlen të theksohet veçanërisht se pjesëmarrja e kufizuar e gruas në prodhimin shoqëror shpjegohet, jo vetëm me prapambetjen ekonomiko-politike të vendit, por edhe me pabarazinë e theksuar shoqërore të saj në jetë, duke u shtuar këtyre edhe konceptet konservatore e reaksionare që ekzistonin për të, sipas të cilave vendi i saj ishte shtëpia dhe rritja e fëmijës, se «ajo nuk është ba me marrë pjesë në jetën publike, në politikë, në drejtimin e shoqnis».³

Këto kushte shoqërore ishin shkak që gruaja të merrej me punët që kufizoheshin brenda katër mureve të shtëpisë, qoftë edhe kur kjo i shërbente asaj si mjet jetese. Prandaj emërtimet më të para që gjejmë për gratë kanë të bëjnë me punën e saj brenda sferave të ngushta të jetës familjare dhe lidhej me disa raste gëzimi ose hidhërimi, për të cilën ajo merrte një shpërblim të vogël.

Mund të sjellim si shembuj emrat, *vajtojcë, shërbëtore, hollojcë, gatojcë, fërkojcë* (ose *fërkuese*) etj. që dëshmojnë nga fjalorët dy-

3) «Cirka» — Shkodër 1937, nr. 31, f. 249.

gjuhësh, si dhe nga botimet e ndryshme periodike e nga folklori p.sh.

«Për me i dhënë shkas edhe më të madh vajit do të merren *vajtojcet* (prefiche) të cillat paguheen postafat për me kja e me britë deri sa të rrinë i dekuni pa u vorrue (G.SH., 1921, 6, 44)⁴. «Stërvitni çupat t'uaja të janë të mira... ndalo-i-ni të sillenë keq me motrat dhe vllëzrit më të vegjël, dhe më tepr'akoma me shërbëtoretë» (M.1928, 3, 77)⁵; «Nji grues me barrë kuerse i afrohet koha e të ramit, do të rrin gati nji grue - *pritse* d.m.th. nji *mami*, e cila po sa të lej në kërtihini merr e lanë me uj të ngroftë dhe e qet në djep» (D. 1929, 1, 21);⁶ «Me një raport të saj ka treguar viktimat dhe shkatërrimet që shkaktojnë *shëronjëset* plaka dhe ka kërkuar të merren masa (D. 1928, 30, 12, 2); «Moj *hollojçë* e, moj *katojçë* / Mori bukepajekun-o/Mori pilafpazimun-o» (K.P.L. 1955. 315);

«Kishte edhe *fërkuese* si F.SH. e cila mjekonte gonoren e grave»⁷ «Në kohë të mesme furka gjindej në dorë të gjithë kujë, pse edhe mret-neshat tiërsihin si çdo *blegtore* dhensh a dhiësh» (G.SH. 1921, 3 22)⁸; «Unë jam i mendjes që e-ja e pa-zâne i duhet vum vetëm atyne fjalëve femnore, qi fundojnë me nji rrokje të gjatë, si vneshtë, mungeshë, *çobaneshë*» (G.R.1929, 9.2)⁹;

Siç duket edhe nga shembujt, emërtime të vërteta për gruan, që ta shënojnë atë sipas një profesioni të caktuar në prodhimin shoqëror nuk kemi.

Edhe gjatë viteve 30, kur hapja e disa fabrikave të vogla e zgjeroi deri diku rrethin e profesioneve dhe detyrave që morën njerëzit në prodhim, pjesëmarrja e gruas në të mbeti ende e vogël.¹⁰

Një pasqyrim të përafërt të emërtimeve që shënonin gruan sipas profesionit mund ta shëjmë në fjalorët dygjuhësh të botuar para çlirimit si dhe në shtypin e asaj kohe.

Në përgjithësi këta fjalorë, emrat e grave sipas profesionit i kanë dhënë në të njëjtën çerdhe me emrat e gjinisë mashkullore, pas tyre. Vetëm në raste të veçanta, kur profesionet kanë qenë specifike për gruan, ose emrat që shënonin gruan sipas profesionit kishin veçori të dukshme në fjalëformim p.sh. (me prapashtesën *-eshë*), janë dhënë veçan, p.sh. *mami*¹¹, *vajtojçë*¹², *bareshë* etj.

Megjithatë emrat e grave sipas profesionit që gjejmë në to, nuk e pasqyrojnë gjithmonë drejt realitetin e jetës, dmth. qenja e emrit në fjalor, nuk vërteton ushtrimin real përkatës të profesionit në jetë.

Ballafaqimi i fjalorëve me materialin e mbledhur nga shtypi i kohës jep, nga njëra anë, profesione që nuk janë ushtruar nga gratë,

4) Shih edhe: *Fjaluer i rii i Shqypes i Shoqnisë Bashkimi*, Shkodër, 1908, f. 249.

5) Shih edhe J. Junku, *Fjaluer i vogël shqyp-itinisht*, Shkodër 1895, f. 127; K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, 1961, f. 326; Bashkimi, f. 418.

6) Shih edhe Junku 75, Kristoforidhi 195, Bashkimi 250.

7) Dr. K. Kërciku, *Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shek. XVIII-XX*, T. 1962, f. 197. (Shih edhe Junku f. 30; Bashkimi f. 108).

8) Shih edhe Bashkimi 46, Junku 10.

9) Shih edhe Junku 18; Bashkimi 75.

10) «Me përjashtim të grave fshatare që merrnin pjesë në punime bujqësore, në gjithë sektorët e tjerë të marrë së bashku punonin vetëm 668 gra... Gratë kryenin punë të dorës së dytë që nuk kërkonin kualifikim» (Bashkimi, 5. 2. 1969, f. 2).

11) Shih A. Leotti, *Dizionario Albanese-italiano*, Roma 1937, f. 641; F. Cordignano, *Dizionario Albanese-Italiano e Italiano-Albanese*, Milano, 1934, f. 104.

12) Shih F. Cordignano, *Dizionario Italiano-Albanese e Albanese-Italiano*, Scutari 1938, f. 226; Bashkimi..., f. 483

por që emërtimet për to autorët i kanë ndërtuar ose sipas modelit, ose thjesht si përkthim të fjalës nga gjuha e huaj në shqip si p.sh. *aktoreshë*¹³, *vjershëtore*¹⁴, *gjyqëtare*¹⁵, apo *gjykatëse*¹⁶, *gjahtare*¹⁷ etj.

Nga ana tjetër, kemi profesione që janë ushtruar nga gratë, por në fjalor emrat përkatës nuk janë përfshirë, gjë që dëshmon edhe për vlerësimin e paktë leksikografik të këtyre emërtimeve si p.sh. *endëse*, *furkatore*, *vegjtore*, *hjektore*, *lase* etj.

Është për t'u theksuar një veçori e emërtimeve të grave sipas profesionit në këtë lëmë para çlirimit: në të vërtetë këto emërtime në fillim nuk dalin si të tilla; ato dalin si emërtime të gruas për një punë të caktuar. Gratë që shquheshin për kryerjen e një pune të tillë, si më të «specializuara», ose të pregatitura, thirrreshin në raste të veçanta edhe jashtë shtëpisë kur paraqitej nevoja. Pra gruaja e «specializuar», e kishte këtë «profesion» jo si mjet kryesor jetese e punë të përditshme, por e ushtronte sipas kërkesave të rastit që i paraqiteshin asaj.

Kështu p.sh. quhej *akçeshë*, *gatojcë*, *hollojcë*, gruaja zakonisht shtëpijake, që thirrej për të gatuar në raste lindjeje, martese, vdekjeje etj. por që nuk e kishte profesionin të përhershëm e punë të përditshme.

Me këto lidhen edhe një varg emërtimeësh të tjera siç janë *vajtojcat* ose *vajtojsët*, që shquheshin për vajtimin e të vdekurve, por që nuk mund të quhej «profesion» i përhershëm, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Po ashtu kishte *shëronjëse*, *pritëse*, *falltore* (*fallçore*, *fallxheshë*.) P.sh. «Në ket nderkohë çojnë e u bajnë za *vajtojseve* të cillat vin të veshuna për jaz, e mlojnë kryet e ftyrën me një rubë të zezë, xanë vend afër të vdekunit e ja fillojnë me vajtue» (Folk. 1940, I, 23)¹⁸; «Në Tiranë si dhe në qytete të tjera, ... vazhdojnë t'ushtërojnë profesionin e tyre si *mamije* e *shëronjëse* disa plaka të veja natyrisht ignorante (G.R., 1929, 7.2, 4)». «Dhe shumë herë foshnja vdes. Pra në të tilla raste *mamia* është e preferuar prej këtyre elementeve (G.R. 1929, 7.2.4)¹⁹; Këtij soj të diejshmit i thonë *fallçuer* o *fallçore*» (Folk. 1940, I, 47)²⁰.

Në këtë mënyrë mund të kuptohet edhe përmbajtja e vërtetë e fjalëve *mjekëse* apo *mjekeshë*, të cilat shënonin gruan që merrej me mjekime popullore, pa ndonjë pregatitje arësimore. P.sh.

«Nji komision i veçantë i për bamë prej *mjekeshash* ka me caktue aftësit e grave për kët shërbim» (B.P.Ush. 1931, 1. 11. 267)²¹.

Krahas këtyre, kemi emërtime që me të vërtetë e shënojnë gruan sipas një profesioni të caktuar. Nga këto mund të sjellim si shembull: *hamalle* ose *hamallicë*, *mësuese* ose *mësonjëse*, *modiste*, *shërbëtore* etj. Këto profesione gruaja i ushtronte vazhdimisht dhe i shërbenin asaj si mjet kryesor jetese. P.sh. «Në Shkodër një numër i madh *hamallicash* (gra malësore e fshatare të varfëra ose të veja që kishin braktisur malësinë) mbushnin rrugët e pazarit»²²; «S'asht e vërtetë se një *msuese*

13) Shih A. Leotti, f. 8.

14) Shih A. Leotti, f. 1632

15) Shih K. Kristoforidhi, f. 130.

16) Shih K. Kristoforidhi, f. 130.

17) Shih K. Kristoforidhi, f. 123.

18) Shih edhe F. Cordignano, f. 226, Bashkimi, f. 483.

19) Shih edhe F. Cordignano, f. 104, A. Leotti, f. 641.

20) Shih edhe Bashkimi f. 105, F. Cordignano, f. 34, A. Leotti f. 176.

21) Shih edhe K. Kristoforidhi f. 216; F. Cordignano, f. 114; A. Leotti f. 745.

22) K. Misha, *Mbi fillimet e lëvizjes punëtore në Shqipëri*, «Buletin i shkencave shoqërore», 1955, nr. 1, f. 36; shih edhe F. Cordignano, f. 36; Bashkimi, f. 277.

është ma morale kur mbas shkollë mbyllet në shtëpi» (Ill. 1935, 28.4.2)²³; «Zonja e tij punon si *modiste*» (J. 1937; 24, 10); «Shum herë thomi që *shërbëtoret* e bëjnë punën shumë mirë, por ky send nuk është një lëvdatë për të zonjat e shtëpisë. (Sh.R.1931, II-III, 24)²⁴.

Rrugën e kalimit nga puna brenda në shtëpi në prodhimin e vërtetë artizanal ose industrial e gjejmë tek fjalët *vegjëtore, hjektores, P.sh.* «Kjo shkallë ma e naltë zhvillimi forcash prodhuese pruni një ndamje të re pune; grueja *prodhuese*; grueja *hjektores**, grueja *vegjëtore** dhe specialitete të tjera.

**Hjektores* thirret ajo grue që heq mëndafsh: nxjerr fijen nga fshikzat.

**Vegjëtore* thirret ajo grue që me vegjë punon vetëm pëlhurë.²⁵

Vlen për t'u theksuar se emërtimet e grave për profesione dhe detyra që kërkonin një shkallë kulture dhe arësimi ishin të rralla në atë kohë. Ndonëse gjejmë edhe emërtime të tilla në literaturën e kohës si *kryetare, nënkryetare, sekretare*: «Parija përbëhet prej shtatë vetash; *kryetares, nënkryetares, sekretares...*» (Rr. Sh. V. shq. 1936, 7); *drejtores*: «Qeverimi i shkollës është në dorë të *drejtores*» (I. A. Kyriaris, 1931, 2); *arkëtare*: «*Arkëtarja* do të ruaj të hollat e shoqnisë» (G.SH. 1921, 5, 36); *artiste*: «*Artistja Z. këndoi Bareshën e Alpeve të Rossini-t*» (Ill. 1936, 4,4, 36); etj. këto janë profesione dhe detyra që ushtroheshin nga grupe të kufizuara të shtresave shoqërore, që nuk përfaqësonin shumicën.

Siç shihet qartë, në pragun e çlirimit, në leksikun e gjuhës shqipe emërtimet e grave sipas profesionit nuk përbënin një shtresë të vërtetë dhe të plotë leksikore; ato ishin fjalë të veçuara që u përgjigjeshin kërkesave të kufizuara të kohës. Në fushën e prodhimit industrial pothuajse nuk mund të bëhej fjalë fare për emërtimet e grave sipas profesionit.

Megjithatë, edhe në këtë numër të vogël emrash ne mund të gjejmë tipat më prodhues të fjalëformimit, tipa të cilët tregojnë se gjuha shqipe i kishte mundësitë e zhvillimit të kësaj shtrese leksikore.

Rruga kryesore e formimit të këtyre emrave është ajo prapashtesore. Në këtë drejtim interes paraqesin emërtimet e gjinisë femërore të formuara mbi bazën e emrave të gjinisë mashkullore me ndihmën e prapashtesave *-e* dhe *-eshë* p.sh. me prapashtesën *-e*; *mjekës-e, shëronjës-e, shërbëtor-e, falltor-e, sekretar-e, mësues-e, drejtor-e, arkëtar-e*; me prapashtesën *-eshë*: *bari-bareshë, akçi-akçeshë, drejtor-drejtoreshë* etj.

Nën ndikimin e këtij modeli, ka pasur edhe formime të tilla si: *mjek-mjekeshë, mami-mameshë*, formime të cilat nuk kanë qëndruar në gjuhë.

Emërtimet e grave për profesione që ushtrohen vetëm prej tyre (emra, vetëm në gjininë femërore) nuk grupohen në tipa të veçantë nga ana e fjalëformimit, me përjashtim të grupit të emrave të vepruesit, që formohen nga foljet dhe prapashtesat e tyre dalin në trajtën: dialektore-cë, si: *hollojcë, fërkojcë, gatojcë, vajtojcë* etj.²⁶

23) Shih edhe Kristoforidhi, f. 112, 212; F. Cordignano, f. 266; Leotti, f. 721.

24) Shih edhe Kristoforidhi, f. 326; A. Leotti, f. 1351.

25) Rr. Zoji, *Tregu i Shkodrës dhe fillimet e industrisë së mëndafshit në vendin tonë*, «Buletin i shkencave shoqërore», 1954 nr. 1. f. 120.

26) «Formanti *-ojcë* në emrat si *gatojcë, hollojcë, kungojcë* të gegërishtes verifërendimore e në morfologjinë e tij nuk është tjetër vegjë -cë zgjeruar me mbare-

*

Në vitet e pasçlirimit, në emërtimet e njerëzve sipas profesio-
nit vihet re një gjallëri dhe pasurim i paparë ndonjëherë. Faktorë të
rëndësishëm që kushtëzuan këtë zhvillim qenë në radhë të parë ku-
shtet e reja sociale që i dhanë mundësi zgjerimit të prodhimit dhe rri-
tjes së pjesëmarrjes së njerëzve në të. Siç e ka theksuar edhe sh. Enver
«Revolucioni proletar, me revolucionin ekonomik-shoqëror, me shka-
tërrimin e pushtetit ekonomik-politik të feudoborgjezisë, krijoi terre-
nin e vërtetë dhe kushtet e përshtatshme të çlirimit të popullit nga
shfrytëzimi i njeriut nga njeriu dhe veçanërisht të gruas shqiptare»²⁷.

Domosdoshmëria e çlirimit të gruas u vu në jetë që në aktet e pa-
ra të Pushtetit Popullor, një prej të cilëve ishte dhënja e të drejtave të
barabarta burrit dhe gruas.²⁸

Revolucioni popullor që zhduku pronën private mbi mjetet e pro-
dhimit dhe zhvilloi prodhimin socialist mbi pronën e përbashkët, si
dhe çlirimi i gruas, krijuan kushte të reja të përshtatshme për pjesë-
marrjen e saj në prodhimin shoqëror. Pjesëmarrja e gruas në prodhim
u bë një nevojë e domosdoshme e kohës. Kështu dalëngadalë, krahas
rritjes dhe zhvillimit të prodhimit, rritet dhe rrethi i profesioneve
e i detyrave, që marrin gratë. Kjo gjë lindi edhe nevojën e emërtimit
të gruas sipas detyrave dhe funksioneve të reja që ajo mori në shoqë-
ri. Kështu filloi procesi i pasurimit të leksikut me emra të grave si-
pas profesionit i cili kaloi jo vetëm në rrugën e pasurimit sasijor (li-
ndjen e shumë fjalëve të reja dhe regjimin e fjalëve të vjetra) por edhe
në rrugën e ndryshimeve cilësore.

Shembja e sistemit të vjetër ekonomik-shoqëror nxori jashtë je-
tës shoqërore një varg nocionesh nga sfera të ndryshme, që lidheshin
me sistemin e vjetër e të kalbëzuar. Kështu dolën jashtë përdorimit të
përditshëm një varg emrash femërorë si: *hamallicë, hyzmeqare, vaj-
tojcë, tellalleshë, fallçore (fallxheshë), gajtojcë, hollojcë, fërkojcë, shë-
ronjëse* etj. dhe një varg emrash mashkullorë, si: *shëgert, tellall,
kazaz, lodraxhi, tabak, bakçi, xherah, saraç, fajdexhi, dhjetar* etj.

Profesione të tilla nuk ushtrohen më, fjalët përkatëse janë vjetë-
ruar, kanë dalë jashtë leksikut të gjuhës letrare dhe mund t'i nde-
shim në raste të veçanta kur jepet koloriti i një vendi, i mënyrës së
jetesës etj.

Kjo është njëra anë e pasqyrimit në gjuhë të ndryshimeve që
ndodhin në jetë. Një anë tjetër, po aqë e rëndësishme, lidhet me ndry-
shimet në përmbajtjen e fjalëve, që vazhduan të qëndrojnë në gjuhë
edhe pas çlirimit. «Në të vërtetë këtu është fjala për pasqyrim në gjuhë
të qëndrimit të ri shoqëror ndaj punës dhe njerëzve të saj, duke
e quajtur të nderuar çdo punë dhe duke treguar njëkohësisht shkallën
e re të vetë mënyrës e mjeteve të punimit... le të krahasojmë fjalën

sën e foljeve të klasës me -oj (e -uaj). Ai i përgjigjet formantit -onjës të toskërishtes,
gegërishtes -ojs, femërore -onjëse, -ojse». A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*,
f. 28.

27) E. Hoxha, *Mbi problemin e gruas*, Tiranë 1967, f. 255.

28) «Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe
shoqërore. Gruaja ka të drejtë të shpërblehet njësoj me burrin për një punë të
barabartë». *Statuti i PPSH*, Tiranë 1946, f. 7.

shërbëtore me *shërbyese*. E para mori kuptimin e punëtore, që bënte një punë, e cila poshtëronte dinjitetin e njeriut, ndërsa e dyta e vë atë në një radhë me çdo punë tjetër; diçka tjetër përsëri të re kemi në kundërvënjen *shërbëtorë të popullit* dhe *shërbëtorë të imperializmit*.²⁹ Bile edhe vetë fjala *shërbyese* sot po përdoret gjithnjë e më pak në jetë; ajo po zëvendësohet me fjalën *pastruese*. Po kështu si rezultat i ndryshimit të përmbajtjes reale të profesioneve, kuptimi i parë i emërtimit të grave sipas tyre është vjetëruar. P.sh. quhej *mjekëse* gruaja që merrej me mjekime popullore dhe sot *mjeke* gruaja që ushtron profesionin e mjekësisë pasi ka bërë studimet përkatëse dhe është diplomuar në këtë fushë, *babo* ose *grua-pritëse*, *mami*, *mamicë*, *mandeshë*, quhej gruaja që ndihmonte lehonën në lindje dhe që përgatitej për këtë me praktikë dhe sot *mami* gruaja e arësimuar, që i kryen gjithë shërbimet lehonës dhe fëmijës, kujdeset për shëndetin e saj para e pas lindjes, *endëse-dje*, gruaja shtëpiake që endte pëlhurë në vegjë primitive dhe sot, punëtorja e kualifikuar, që punon në fabrikën e tezgjahut: *shplekëse-dje*, gruaja që shplekste lesh me dorë dhe sot, gruaja që qëndron pranë maqinës së shpleksjes dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj (shpleksjen e pambukut ose leshit e bën maqina) etj.

Edhe në vitet e para pas çlirimit vazhdoi përpjekja e filluar që në kohën e Rilindjes, për zëvendësimin e shumë fjalëve të huaja të panevojshme, të hyra nga gjuhët e tjera, me fjalë të ndërtuara nga brumi i shqipes, si p.sh.: *modiste* (*modhistër*), *terzeshë* me *rrobaqepëse*, *jatreshë* me *mjeke*; *dhaskal*, *dhaskalicë* me *mësues-e*, *mësonjës-e* etj. Ndonjërë prej tyre si *dhaskal*, *dhaskalicë*, mori ngjyrim emocional, përbuzës për një mësues a mësuese pedant të paaftë.

Një pasqyrë të përafërt të emrave që shënojnë gruan sipas profesionit për 10-vjeçarin e parë pas çlirimit, ne mund ta kërkojmë tek «Fjalori i gjuhës shqipe» botuar më 1954. Duhet theksuar se në këtë fjalor nuk janë pasqyruar në masën e duhur emërtimet e njerëzve sipas profesionit, veçanërisht emrat e grave, duke mos u kapur prirja e zhvillimit të shqipes në këtë drejtim.

Emrat e njerëzve sipas profesionit, përbënin një shtresë leksikore me prirje të gjera pasurimi dhe zhvillimi; ky ishte një proces i natyrshëm, që diktohej nga zhvillimi i pandërprerë i prodhimit dhe i pjesëmarrjes së gjerë të gruas në të. Prandaj këta emra duhet të zinin vend më të gjerë në fjalor. Kështu për emrat që shënojnë gruan sipas profesionit janë dhënë këto: *akçeshë*, *aktoreshë*, *arësimtare*, *artistë*, *barëshë*, *blegtore*, *çobanëshë*, *daktilografe*, *daktilografiste*, *dhaskalicë*, *dhaskaleshë*, *edukatore*, *endëse*, *fallçore*, *fallxheshë*, *fërkojse*, *furkatore*, *gatojcë*, *gazetare*, *infermiere*, *kameriere*, *kërcimtare*, *korrëse*, *magjistare*, *magjistrice*, *mami*, *mamicë*, *mbjellëse*, *mësonjëse*, *mësuese*, *mjekëse*, *mjektare*, *modiste*, *modhistër*, *normiste*, *pikulëshë*, *qendistare*, *rrobaqepëse*, *stenografe*, *shërbyese*, *vajtore*, *vajtojcë* dhe nuk janë pasqyruar një varg emrash të tjerë që shënonin gratë sipas profesioneve dhe detyrave të reja që ato morën në shoqëri si p.sh. *agronome*, *brigadiere*, *elektricieste*, *frezatore*, *inxhiniere*, *maqiniste*, *mjeke*, *motoriste*, *telefoniste*, *tornitore*, *traktoriste* etj. Po e ilustruam këtu me citate, të nxjerra nga botimet e kohës.

«Ministria më dha titullin *agronome* e mesme (Sh. R., 1950, 2, 26);

29) Xh. Lloshi, *Gjuha dhe jeta*, «Ylli», 1966, nr. 1, f. 10.

Ato nuk janë vetëm fshatare që punojnë kopshtin, ... janë *brigadiere*, (Sh. R., 1951, 11, 4); Në çdo sektor pune ka gra *tornitore*, *maqiniste*, *fugiste*, *traktoriste*, *lokomotiviste*, *elektriçiste*, *frezatore*, *saldatore*, *motoriste e laborante* (Sh. R. 1952, 7, 16); gratë *inxhiniere artiste*... kanë vënë të gjitha fuqitë... në shërbim t'adheut (Sh. R. 1946, 5.9); «Sot mbaj emrin *makiniste* (Sh. R. 1951, 4, 4); «Sot jam e lumtur... që si *mjeke* do t'i shërbej popullit (Sh. R. 1951, 5-6, 20)»; «Drita u ba *tornitore* (Sh. R. 1952, 11, 15); Fshatarja *traktoriste* P. Gj. delegate në kongr. II (Sh. R. 1946, 9, 17); *Dy telefoniste*, D. dhe L. S. ishin të zëna me punën e tyre... (Sh. R., 1946, 4,3);

Sigurisht përdorimi i gjerë i këtyre emërtimeve rreth viteve 1950, tregon se këto profesione janë ushtruar nga gratë dhe para kësaj kohe.

Një rritje të madhe të emrave të grave sipas profesionit vëmë re sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit, sepse zëvendësimi me gra i një sërë detyrash dhe profesioneve që ushtroheshin përpara vetëm nga burrat³⁰ nxori në jetë edhe fjalët korresponduese të gjinisë femërore që emërtuan gruan sipas detyrës dhe funksionit të ri.

Këta emra të rinj i kemi mbledhur në ndërmarrje prodhuese, ku është mbizotëruese puna e gruas³¹. Për të vërtetuar gjerësinë e përhapjes së tyre në gjuhë, kemi shfrytëzuar literaturën letrare-artistike, shkencore dhe publicistike të kohës.

Vëzhgimet tona në këtë drejtim nxjerrin në pah rrugët kryesore të formimit të emërtimeve të grave sipas profesionit, të cilat në gjuhën e sotme shqipe janë dy:

A — Formime prapashtesore

B — Formime të pavarura (emërtime vetëm në gjininë femërore).

A. Formimet prapashtesore

Emërtimet e grave sipas profesionit, që formohen me ndihmën e prapashtesave, përbëjnë sot rrugën më prodhuese. Këta emra formohen kryesisht mbi bazën e emrave të gjinisë mashkullore me ndihmën e dy prapashtesave: *-e* dhe *-eshë*.

Formimet me prapashtesën -e

Formimet me prapashtesën *-e* nga ana strukturore mund t'i ndajmë në:

- 1) Formime prapashtesore nga tema të prejardhura të gjinisë mashkullore.
- 2) Formime prapashtesore nga tema të përbëra të gjinisë mashkullore.

30) «Në vitin 1968, mbi 250.000 gra e vajza kanë marrë pjesë në prodhim. Këto përbëjnë 42 përqind të numrit të përgjithshëm të punonjësve të fshatit e të qytetit». «Zëri i popullit», 8.III.1969, f. 3.

31) Në Tiranë: në «Kombinatin e tekstileve Stalin»; në Kombinatin ushqimor «Ali Kelmendi»; në Kombinatin «Josif Pashko», në Uzinat: «Dinamo», «Tirana», «Partizani», në NISH Pelicerinë, në NISH Porcelanin, në NISH Qeramikën, në NISH Profarmën. Në rrethin e Durrësit: në NISH Gomën, në Fabrikën e cigareve, në Fermentimin e duhanit. Në rrethin e Shkodrës: në Fabrikën e telit, në Fabrikën e letrës, në NISH Tisazh-mëndafshin dhe NSHGID.

1) *Formime prapashtesore nga tema të prejardhura të gjinisë mashkullore* — Në këto formime zënë një vend të rëndësishëm emrat e grave sipas profesionit që formohen me prapashtesën -e. Kjo prapashtesë duke u bashkuar me emra të prejardhur të gjinisë mashkullore, formon emra të grave sipas profesionit. Kështu p.sh. nga: -tar (pres-tar+e, qendis-tar+e, këpucë-tar+e); -ës (tjerr-ës+e, gdhend-ës+e, pjek-ës+e, prer-ës+e, end-ës+e, bër-ës+e, skalit-ës+e); -ues (llustrues+e, klasifikues+e, seleksionues+e, peshues+e, montues+e, shtrues+e, asfaltues+e, manipulues+e, stampues+e) etj.

2. *Formime prapashtesore nga temat e përbëra të gjinisë mashkullore*. Ndër rrugët kryesore të formimit të emrave të njerëzve sipas profesionit zënë një vend të rëndësishëm formimet me tema të përbëra. Kjo rrugë, që është mjaft prodhuese në shqipen e sotme, paraqet interes të veçantë gjuhësor, sepse me ndihmën e saj po zëvendësohen mjaft fjalë të parme dhe formime ekzistuese sufiksale, veçanërisht me prapashtesën turke -xhi³². Tek të gjithë këta emra vihet re një farë prirje e shqipes, për ta zberthyer nocionin përkatës. Me këtë rrugë prodhuese formohen edhe emra të gjinisë femërore nga temat e emrave mashkullore, me prapashtesën -e.

Në fakt tek emrat femërorë kemi të bëjmë me formime prapashtesore. Ato formohen mbi bazën e emrit mashkullor, pavarësisht nga struktura e tij, me prapashtesën -e. Kështu p.sh. *hekurpunuese* është formuar nga *hekurpunues+e*; *kryeinxhiniere* nga *kryeinxhinier+e* etj. Nga emrat e gjinisë femërore që formohen prej temave të përbëra të gjinisë mashkullore, mund të përmendim disa si: *leshpunuese*, *jorganpunuese*, *hekurpunuese*, *suvapunuese*, *robalarëse*, *rrobaqepëse*, *pllakashtruese*, *libralidhëse*, *ndihmësmaqiniste*, *ndihmëstraktoriste*, *ndihmësvakumiste*, *ndihmëspjekëse*, *ndihmëslogaritare*, *kryeinxhiniere kryellogaritare*, *kryenormiste* etj.

Po i ilustrojmë këto emra me disa shembuj nga literatura:

«Shembull tipik për këtë është *hekurpunuesja* e kategorisë së pestë. F.V.» (Z.P. 1967, 27.10.2); «Pasqyra e llojeve të punëve ku gratë marrin lejen e barrëldjjes prej 14 javësh, 3. *suvapunuese*» (S.Sh. Sht. 1968, 57); «*Jorganpunuese* quhet punëtorja që merret me punimin e jorganëve, mbushjen, qepjen»³³; «Unë do... bëhem *rrobaqepëse*» (Sh. R. 1961, 4, 3); «I. Në punimet e ndërtimit. 8) *pllakashtruese*» (S. Sh. Sht. 1968, 57); «*Libralidhëse* quhet punëtorja që merret me të gjitha operacionet e lidhjes së librit»³⁴. «*Shoqja librashitëse* shet libra» (Z.P. 1967, 15.2.3); «*Peshkatarët, rrobalarëset*, «bojaxhinjtë», (S.SH.Sht. 1968, 7); «Në repartin e grave pothuaj se pjesa më e madhe e grave ishin *ndihmësmaqiniste*» (Sh. R. 1963, 3, 4); «*Sot gratë i gjen kudo, në çdo sektor të jetës, ndihmëstraktoriste*» (Z.P. 1967, 17. 10.6); «T.K. ... sot është *ndihmësvakumiste*, drejton një sektor me rëndësi» (Sh. R. 1952,

32) «Jo vetëm fjalët e futura nga turqishtja, por edhe disa morfema formante, siç janë prapashtesat -llëk, -xhi përdoren çdo ditë e më pak në gjuhën tonë. Në vend të prapashtesës -llëk tek ne përdoren tashti në shkallë të gjerë prapashtesat -si, -i, -ri dhe në vend të prapashtesës -xhi përdoren prapashtesat -tar, -ar etj. (p.sh. furrtar, këpuqtar etj.) ose mbiemrat foljorë të substantivuar — punonjës (punues), -bërës, -ndreqës, si komponentë të dytë të fjalëve të përbëra që tregojnë njerëz sipas profesionit të tyre (p.sh. qeleshepunues në vend të qeleshexhi, bakërpunues në vend të bakërxhi, samarbëres në vend të samarxhi, orëndreqës në vend të sahatçi etj.). A. Kostallari, *Në rrugën...*, f. 36-37.

33) Mbledhur në Kooperativën leshpunuese, Berat, 1963.

34) Mbledhur në Stabilimentin Mihal Duri, Tiranë 1968.

8. 25); «Ajo e nisi punën në NIL — bukën e Tiranës si *ndihmëspjekëse*» (Z.P. 1965, 10, 1, 3); «Më vonë mësuem se ata janë dy *ndihmëstekniket* e repartit të saj» (Sh. R. 1962, 6, 9).

Formimet me prapashtesën -eshë

Me ndihmën e kësaj prapashtese formohen emrat e grave sipas profesionit, mbi bazën e emrave të gjinisë mashkullore, në një masë më të vogël se ato që formohen me prapashtesën *-e*. Zakonisht kjo prapashtesë u është ngjitur emrave mashkullorë nga tema të thjeshta, si p.sh. *bari — bar-eshë*, *bujk — bujk-eshë*, *çoban — çoban-eshë*, si dhe *doktor — doktor-eshë*, *drejtor — drejtor-eshë*, *poet — poet-eshë*, *profesor — profesor-eshë* etj.³⁵

Në gjuhën e sotme shqipe krahas formimit të disa emrave me *-eshë*, vihet re prirja e zëvendësimit në disa raste me prapashtesën *-e*. Kështu krahas *drejtoreshë* përdoret *drejtore*; *poeteshë — poete* etj.

B. Formime të pavarura (Emërtime vetëm në gjininë femërore)

Formimet e pavarura që tregojnë emrin e gruas sipas profesionit kanë lindur në gjuhë për specialitetet, që janë karakteristike vetëm për gratë. Një profesion i caktuar që është ushtruar që në të lindur të tij nga gruaja, ka sjellë si rezultat që edhe emërtimi i punëtores të formohet përkatësisht vetëm në gjininë femërore.

Kështu kemi emërtime të tilla nga tema shqipe si *mjelëse*, *tjerrëse*, *hapëse*, *dredhëse*, *dhënëse*, *marrëse* etj., nga huazime të thjeshta e të prejardhura si *mami*, *manikyriste* etj.

*

Klasifikimin e bërë në bazë të tipeve kryesorë dhe mjeteve fjalëformuese, po e plotësojmë më tej me analizën kuptimore të këtyre emrave.

Emrat e grave sipas profesionit nga ana kuptimore mund të lidhen me:

- a) Emërtime sipas procesit të punës.
- b) sipas maqinës.
- c) sipas objektit të punës.
- d) sipas lëndës.
- e) sipas veglës.
- ë) sipas vendit të punës
- f) emërtime të ndryshme.

a) Emërtime sipas procesit të punës:

Emërtimet e grave sipas profesionit, të formuara nga tema foljore që tregojnë procesin e punës, përbëjnë sot jo vetëm grupin më të madh të këtyre emërtimeve, por edhe bazën e pasurimit të mëtejshëm me formime të reja. Prodhueshmëria e këtij tipi lidhet me një varg faktorësh siç janë: zhvillimi i gjerë i prodhimit socialist, mekanizimi dhe

35) «gjan të kenë ndikuar emrat përkatës me *-essa* të italishtes». A. Xhuvani — E. Çabej; *Prapashtesat...*, f. 38.

ndarja e proceseve të punës, specializimi i punëtorëve në to etj. Të gjitha këto shtruan nevojën e emërtimit të punëtores jo në përgjithësi, por sa më saktë, duke u bazuar në punën konkrete që ajo bën. Kështu p.sh. në qoftë se në Kombinatin «Josif Pashko» Tiranë, quhen në përgjithësi punëtore të gjitha ato që punojnë aty, në veçanti quhen *fërkuese*, *gryrëse*, *lidhëse* etj.

Po e ilustruamë këtë me disa shembuj siç janë: *endëse*, *gatuese*, *qëndistare*, *prerëse*, *tjerrëse*, *prestare*, *përshkuese*, *dhënëse* etj.

«Ajo është bërë një *endëse* shumë e mirë» (Sh. R. 1962. 2,3); «Ppulli ka zgjedhur në kryesi 4 anëtare, në përfaqësi 60 anëtare... 20 mjelëse dhe *gatuese* bukësh» (Z.P. 1967. 20.5,3); Sot, do tu kishnje ngrënë hakun këtyre të rejave.. «*qëndistare* të filigranit»... (Y. 1961,6,8); «Vlen të përmendësh *prerësen* M.T. që s'kursethet as në punë as në gështjet e organizatës» (Sh. R. 1962, 4, 3); «*Tjerrësja* A.R. gjatë 15 ditëve. . . pregatiti 486 kg. fije më tepër nga norma» (Z.P. 1953, 31.7, 1); «Punoj si *prestare* në NIL prodhime Tiranë, në repartin e këmisherisë (P.1958 25.2, 2); «*Përshkruesja* Sh. R. dhe *dhënësja* N.G. kanë arritur tani të përshkojnë një numër të madh fijesh në bazën me dok veror» (Z.P., 1966, 1-4, 2) «Tani ajo është edhe *stampuese* edhe *shkrirëse*..» (Z.P. 1968, 19.5,3); «Edhe puna nuk është e zorshme. *Kallafatore* nuk është keq» (N. 1967, 6, 21); «Nga këto 8294 marrin pjesë drejtpërsëdrejti në prodhim si *endëse*, *rrobaqepëse*, *mobiljere*, *suvatore*, *motoriste*» (Z.P. 1961, 19.8,2).

bluese-ja quhet punëtorja, që bluan me maqinën e blojes mish ose kocka (K.m. — T.); *dredhëse* — ajo që dredh fillin e pambukut me maqinën e dredhjes (K. Mao Ce Dun — B.); *dhënëse* — i jep punëtores *marrëse* fillin e pambukut pasi e përshkon në maqinën e përshkimit (K. Mao Ce Dun — B.); *fërkuese* — fërkon pllakat e granilit me rërë për t'i hequr ashpërsinë (K. J. Pashko — T.); *gryrëse* — gryen me gur zmerili pjesën e prehur të prodhimeve të papërfunduara (gota, kana etj.) (Nish-q. — T.); *hapëse* — hap, ndan në punëtoret e repartit pjesët e veçanta të këmishëve për t'i qepur (N.Sh.R.G. — T.); *heqëse* — heq zorrët nga bagëtia e therur, heq dhjamin nga organet e brendshme të bagëtive (K. m. — T.); *holluese* — hollon brumin e bukës, i jep trashësinë dhe formën e duhur (F.b. — T.); *kthyesë* — kthen me maqinë këndin e thesit të letrës (F.L.Sh.), kthen anët e faqeve të këpucëve (F.K. — T.); *larëse* — lan prodhimin për t'i hequr ngjyrën e tepërt (Nish — TM — Sh); *lidhëse* — lidh prodhimin për të lehtësuar transportimin (K.J. Pashko T.; Nish — TM — Sh); *marrëse* — merr nga punëtorja *dhënëse* fillin e pambukut pasi ka kaluar në maqinën e përshkimit (K. Mao Ce Dun — B.); *matëse* — mat prodhimin me metër (Nish. TM — Sh.); *mbledhëse* — mbledh nga punëtoret e klasifikimit fletët e duhanit të ndara sipas kualiteteve (F.D. Sh.D.); *mbushëse* — mbush cigaret me dorë (F.C. Sh. D.); *mbush zorrët* e bagëtive me mish (K.m. — T.); *numëruese* — numëron letrat dhe ja dorëzon punëtorëve për normën ditore (F.C. — D; U.T. — T.); *paraqitëse* — paraqet dengun e duhanit para kontrollorit, i cili përcakton kualitetin e tij (F.D. — D.); *qepëse* — qep dëngjet e gjetheve të duhanit (F.D. — D.); *rrumbullakosëse* — rrumbullakos prodhimet e qelqit me gazogjen (Nish—Q.—T.); *shkrifëse* — shkrif pambukun me dorë para se ta fusë në maqinën e shkrirjes (K. Mao Ce Dun — B.); *shumfishuese* — shumfishon fillin e pambukut për t'i dhënë rezistencë (K. Mao Ce Dun — B.); shumfishon

tabakët e letrës (F.L. — Sh.); ushqyese — ushqen maqinat me duhan (F. C. — D.); *zbrazëse* — zbraz papastërtitë nga zorrët e bagëtisë së therur (K.m. — T); *shfletuese* — shfleton fletët e duhanit nga vargu dhe i ndan në klasa (F.D. — Sh.); *etiketuese* — etiketon, u ngjit etiketën prodhimeve të gatshme për treg (K.U. — T.); *klasifikuese* — klasifikon kualitetet e prodhimeve (K.U. — T.); *zmaltuese* — zmalton, vesh me zmalto prodhimet e papërfunduara (Nish — Q. — T.).

b) Emërtime sipas maqinës

Vendin e dytë nga gjerësia e formimit të tyre e zenë emrat e grave sipas profesionit që lidhen nga ana semantike me emrin e maqinës me të cilën punon punëtorja. Edhe ky është sot një tip mjaft prodhues në gjuhë, sepse përdorimi i teknikës moderne, zëvendësimi i punëve të dorës me maqina e aparate të reja, sjellin si rezultat edhe emërtimin e punëtores sipas maqinës me të cilën punon. Po sjellim disa shembuj si: *frezatore, kombajnere, linotypiste, retifikatore, shaptilografiste, motoristë, pompiste, maqiniste, tezgjahiste, traktoriste, vinçiere, buldozeriste* etj.

«Frezatorja E.S. duke punuar në frezat automatike» (Y. 1967, 2, 19); «Tungjatjeta shoqja kombajnere, të përshëndesim pë punën tënde të kujdesëshme» (Sh. R. 1964, 11, 18); «Bukuria qëndron edhe në shkathtësinë e mëndjes -- tha *linotypistja* A.A.» (Sh. R. 1966, 8, 22); «Retifikatorja Sh.B. gjatë punës për prodhimin e stampës së menteshave» (Sh. R. 1967, 3, 20); «Kjo *shaptilografiste* e shkathët.. kryen një punë... me përgjegjësi» (Z.R. 1962, 12,9); «Në njerin prej tyre është *motoriste* një grua, H.M.» (Sh. R. 1954, 1,7); «Si kjo puntore, takon në çdo repart të uzinës si *pompiste, tornitore, vinçiere*» (Sh. R. 1967, 6, 24); Nga dy gra që punonin si *maqiniste* në Nish-sharra në Kaç, tani punojnë mbi 40» (Z.P. 1962, 20,9,3); «Mësova aty teknologji dhe specializim për *tezgjahiste*» (Sh. R. 1954, 5, 2); «A.A., *tornitorja* e asaj tornos së vjetër, mprehu thikat e para» (Z.P. 1967,2, 3,3); «Ka 8 vjet që punon si traktoriste në fermën e Fierit» (Sh.R. 1961, 2,1); «Ato janë *tornitore, frezatore, vinçiere, elektrobobinatore* etj.» (Sh.R. 1966, 10,9); «Pasqyra e llojeve të punëve ku gratë marrin lejen e barrë-lindjes 14 javësh... *buldozeriste*» (S. Sh. Sht., 1968, 57);

c) Emërtime sipas objektit të punës

Këto emërtime lidhen nga ana kuptimore me emrin e objektit të punës. P.sh. quhet *opingere* — ajo që bën dhe ndreq opinga; *këpuccare* — ajo që bën dhe ndreq këpucë.

«Sot ka vajza që punojnë si *opingere, këpuccare* etj. (Z.P. 1967, 22,7, 1). «Sot gratë i gjen kudo... *këpuccare, berbere* etj. (Z.P. 1967, 27,10, 6).

Grupet e tjera të emërtimeve që nga ana kuptimore lidhen me lëndën, veglën, vendin e punës etj. megjithëse përbëjnë disa rrugë të pasurimit të leksikut me emërtime të grave sipas profesionit, janë më pak prodhuese se grupet që shënuam më lart. Kështu kemi:

d) *Emërtime sipas lëndës: betonist-e* = pregatit beton.

Pasqyra e llojeve të punëve ku gratë marrin lejen e barrë-lindjes prej 14 javësh: 5) *betoniste* (S.Sh. Sht. 1968, 57).

e) *Emërtime sipas veglës: zdruckthtar-e* = punon me zdruckth. Ato ndërtojnë mure, ... Janë edhe *zdruckthëtare*.

ë) *Emërtime sipas vendit të punës: banjaxheshë, magazinierë, farmacistë, sporteliste, arkëtare* etj.

f) *Emërtime të ndryshme*

Këtu hyjnë emërtime të grave sipas profesionit që nuk lidhen nga ana kuptimore me asnjë nga tipet që trajtuam më lart si p.sh. *xhenerike, mekanike, operatore, shofere* etj.

«Sot gratë i gjen kudo, në çdo sektor të jetës — *xhenerike*» (Z.P., 1967, 27.10, 6); «Punë dhe profesione në të gjithë sektorët... *mekanike* (S.Sh. Sht. 1968, 64); «Ato.. janë një varg i tërë prej 38 pompistesh, 20 laborantesh, 7 *operatoresh* (Z.P. 1968, 1. 5, 3); «Punë dhe profesione në të gjithë sektorët. 83. *shofere* dhe punëtore në automjete (G.Z. 1967, 3, 40);

Një vend të veçantë në fushën që po trajtojmë, zënë emrat që shënojnë gruan sipas vendit të saj drejtues dhe sipas detyrave të tjera tekniko-drejtuese dhe administrative që lidhen po me këtë fushë. Këta emra tregojnë qartë se gruaja në shoqërinë tonë hyn jo vetëm si punëtore e thjeshtë që kryen detyra të dyta, por edhe si kundër, e aftë të drejtojnë sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe të marrë pjesë në drejtimin e shtetit.³⁶

Të tillë janë:

«Një punë të mirë ka bërë *inxhinierja* V.P. (Shk. 1967, 6.12, 4); «*Teknologeja*... H.B. deklaroi se në fabrikën e konservave vihet re një gjallëri e jashtëzakonshme...» (Sh., 1967, 28.10, 1); «E. është 21 vjeç, akoma e vogël por për një muaj merr emrin *kimiste*» (Sh.R., 1961, 6,1); «Kur u afrua *gjeologeja*, disa u hapën që ajo të dilte përpara» (N. 1959, 3, 44); «Në krye të të gjithë inxhinierëve të Kombinatit është kryeinxhinierja V. A. deputete e Kuvendit Popullor» (Sh. R. 1966, 10, 25); si dhe: *brigadiere, normiste, përgjegjëse* (turni, skuadre), *shefe* (prodhimi, kuadri, llogarie), *mjeshtre* (turni, sektori), *drejtoreshë, llogaritare, ministre, protokolliste, sekretare* (e organizatës bazë, e këshillit të gruas), *kryetare* (dege, e bashkimeve profesionale, e këshillit të BGSH), *ndihmësmjeshtre, ndihmësbrigadiere, nënkryetare, kryenor-miste, skuadërkomandante, zëvendëskryetare, zëvendëssekretare, zëvendësbrigadiere, zëvendësdrejtoreshë* ose *zëvendësdrejtores, zëvendësministre* etj.

36) «Gratë përbëjnë 38,5 përqind të kuadrove të mesme dhe të larta të vendit. Mbi 600 gra e vajza drejtojnë ndërmarje, fabrika dhe institucione social-kulturale», Zëri i popullit, 8.III.1969, f. 3.

Të parë nga vendi që zënë në leksikun e gjuhës letrare, emrat e grave sipas profesionit mund t'i grupojmë në emra që kanë kaluar në gjuhën letrare dhe janë bërë pronë e saj dhe në emra që janë relativisht të rinj dhe nuk kanë hyrë në leksikun e përgjithshëm të gjuhës letrare.

Shumë emra nga shkalla e përdorimit dhe e përhapjes së tyre në gjuhë, kanë kaluar nga leksiku i ngushtë profesional në leksikun e përgjithshëm të gjuhës letrare. Vlen të theksohet se këta emra, përfaqësojnë profesione që ushtrohen gjerë në jetë; përhapjen e tyre e gjejmë jo vetëm në frontin e prodhimit por edhe në botimet e ndryshme, letërsinë artistike, politiko-publicistike, shtypin tonë të përditshëm e periodik.

Të tilla janë emrat nga tema shqipe: *endëse, prestare, këpucare, opingare, qendistare, argjendare, zdrukthtare, gdhendëse, pjekëse, llogaritare* etj. dhe fjalët e përbëra: *rrobaqepëse, rrobalarëse* si dhe *librashitëse, libralidhëse, hekurpunuese, hekurthyese* (si formime më të vona); nga tema të huazuara ose internacionale, por që proçesi i formimit të emrave në gjinitë femërore është kryer në truallin e shqipes si: *tornitore, axhustatore, frezatore, saldatore, fonditore, kallafatore, montatore* etj. Po i ilustruojmë me disa shembuj:

«Sot punojnë si *tornitore*, *axhustatore*, *sharriste* etj. 11 shoqe (Sh. 1967, 4. 11, 2); «Ajo ishte shtëpijake, pastaj u bë *tornitore*» (Z.P. 1969, 8. 3, 3); «Drita u bë *tornitore*» (Sh. R. 1952, 11, 15); «Punë dhe profesione në të gjithë sektorët 85. *axhustatore*» (S.Sh. Sht. 1968, 63); «Z. A. duke u konsultuar me *axhustatoren* E. T. për cilësinë e punës» (Z.P. 1967, 28. 1, 2); «*Frezatorja* sapo ka filluar punën në një piston të ri, kur dëgjon se po e thërrasin» (Sh. R. 1966, 9, 8); «Kjo i ka nxitur gratë punonjëse në mjaft qëndra pune që të përvetësojnë mjeshtëri të tilla si për *tornitore*, *frezatore* (Z.P., 1967, 20. 12,2); «Sa fëmijë kini? pyetëm *saldatoren* e vjetër të uzinës së naftës» (Sh. R. 1964, 8, 10); «Në çdo sektor ka gra... *frezatore, saldatore*...» (Sh. R., 1952, 7, 16); «Janë 20 gra e vajza *fonditore*» (Z.P., 1968, 19. 5, 3); «...Motra ime e madhe u fut në oficinën e hekurudhës si *fonditore*». (Z.R. 1957, 27. 11, 2); «*Është disenjatore* — më tha inxhinieri» (D. 1968, 18. 2, 3); «...*dizenjatorja* D. C. po përfundon projektin e detalit të një makine të rëndë» (Y. 1966, 7, 6); «Shumë të reja shtëpijake sot punojnë si *kallafatore* në kantierin detar» (B. 1948, 19.5, 3); «...puna nuk është e zorshme, *kallafatore* nuk është keq». (N. 1967, 6, 21); «Pastaj unë fola me *retifikatoren* e kujdesëshme, Xh. G.» (Sh. R., 1966, 7, 8); «Takoje edhe të rejat B. R. e N. P. të dyja janë *retifikatore*...» (Y. 1967, 12, 14); «Punë dhe profesione në të gjithë sektorët... *montatore*» (S. Sh. Sht., 1968, 64); «Kjo është N., është emëruar *montatore* nga drejtoria» (A. A. T. 1962, 182); «Gratë e vendit tonë i gjen sot... *maqiniste* lokomotivash» (Sh. R. 1953, 5, 12); «Në Kombinatit e drurit numurohen... 54 *maqiniste* të proceseve të ndryshme» (Sh. 1967, 28.10, 3); «Punë dhe profesione në të gjithë sektorët... *Motoriste* në repartet e riparimit të mekanizmave» (S. Sh. Sht. 1968, 64); «Në çdo sektor pune ka gra... *motoriste*, laborante» (Sh. R. 1952, 7, 16); «Sot gratë punojnë në uzinë si puntore, në tec si laborante, *pompiste* etj.» (Sh. R., 1963, 12, 9); «...50 gra... zëvendësuan me sukses burrat në profesione të ndryshme, si *pompiste*, *grasatoriste*, *brigadiere* etj.» (Z.P. 1967, 14. 10, 3); «Në centralin urban,

telefonistja Dh. N. pati fatin të komunikojë e para me Korçën» (Z.P. 1967, 3, 1, 3); «Pas një stërvitjeje të gjatë, ajo përsëri dëgjon, bile punon edhe si *telefoniste*» (Sh. R. 1968, 5, 30); «Mësova aty teknologji dhe specializimin për *tezgjahiste*» (Sh. R. 1954, 5, 2); «Me një frymë të lartë revolucionare diskutuan rreth detyrave të reja *tezgjahiste*.» (Z.P. 1968, 27.7,1); «Ka 8 vjet që punon si *traktoriste* në fermën e Fierit» (Sh. R. 1961, 2,1); «D. u bë *traktoriste*.» (Y. 1968, 2, 16); «Në çdo sektor pune ka gra. *elektricioste*» (Sh. R. 1952, 7, 16); «N. T. është *elektricioste*» (Z.R., 1969, 8, 3,3); «Punë dhe profesione në të gjithë sektoret... *shaptilografiste*.» (S. Sh. Sht., 1968, 64); «94. *Shaptilografiste* (që punon 8 orë në ditë)» (G.Z. 1967, 3, 40); «Është i 12 vjet që Q. punon si *telegrafiste* pranë PTT-së Tiranës» (Sh. R., 1959, 4, 13); «Në kursin për daktilografe marrin pjesë 12 veta, në kursin për *telegrafiste* 9 veta» (B., 1948, 28.4, 2); «*Telefonistet* e trembura, duke bërë titur rendnin nëpër godinë» (K.L. Sh.); «*Telefonistja* m'u përgjegj se do të më lidhë me agjentin që më duhet» (K. L. Sh.); «900 gra e vajza *tekstiliste* nxjerrin nga duart e tyre qilimë të bukur» (Z.P. 1968, 8, 3,3); «. *tekstilistja* e dalluar E.M. punon për llogari të vitit 1963» (Z.P., 1960, 19.11, 1); «Ato janë tornitore, frezatore, *vinçiere*.» (Sh. R. 1966, 10, 9); «*vinçiere* të guximëshme që nga kabina e lartë vështrojnë si në pëllëmbë të dorës qytetin» (Sh. R. 1968, 2, 14); «Në disa procese pune, të rënda që deri dje punonin e drejtonin burrat, sot punojnë e drejtojnë gratë, si p.sh. *vinçiere*» (Sh. 1967, 28. 10, 3); 71. *kombajnere* ose autokombajnere dhe ndihmëse të tyre» (G. Z. 3, 1967, 39); «Disa prej tyre janë bij e bija të popullit të rrethit të Krujës, siç janë *inxhinierja*» B.Z. (Z.P., 1968, 26.3, 1); «Ato i shikon nga puntore të thjeshta, teknike dhe *inxhinierë*.» (Sh. R. 1954, 5, 1); «*Teknikja* P.S. 4 herë sulumuese.» (Sh. R. 1952, 8, 11); «Përhëndetën gjithashtu *teknikja* e N.B.SH. së Sukhit L.G.» (Z.P. 1968. 9.3, 1); «. *rradhët e metalurgeve* të dalluara, do t'i shtojmë çdo ditë» (Sh. 1967, 25.10, 3); «Dhe jo vetëm burra, por edhe gra — gra *metalurge!*» (Z.P. 1968, 27. 3, 3); «. *përgjegjëse* fabrikash, *inxhinierë*, *ekonomiste*, *teknologe*.» (Z.P. 1967, 23.3, 3); «*Teknologueja* e NISH ushqimores H.B..» (Sh., 1967, 28.10,1).

Disa emra të tjerë nga shkalla e përdorimit dhe e përhapjes së tyre në gjuhë, nuk kanë kaluar në leksikon e përgjithshëm të gjuhës letrare. Duhet theksuar se këta emra shprehin profesione nga më të rejat, të cilat kanë lindur mbi bazën e copëtimit të punës dhe specializimit të punëtorëve të veçantë në to. Këta emra përbëjnë tipin më prodhues në gjuhë që ndërtohen mbi bazën e foljes dhe tregojnë procesin e punës së punëtores. Të tillë janë: *bluese*, *dredhëse*, *dhënëse*, *fërkuese*, *gryrëse*, *hapëse*, *heqëse*, *holluese*, *kthyesë*, *larëse*, *lidhëse*, *marrëse*, *matëse*, *mbledhëse*, *numëruese*, *paraqitëse*, *qepëse*, *rrumbullakosëse*, *shkrifëse*, *trashuese*, *ushqyese*, *zbrazëse* etj. si dhe *etiketuese*, *presuese*, *asfaltuese*, *klasifikuese*, *manipuluese*, *stampuese*, *zmalluese* etj.

Në këtë proces të madh lëvizjeje dhe pasurimi të kësaj shtrese leksikore, vihet re para së gjithash prirja për një gjuhë sa më të pastër shqipe, përpjekja për të ndërtuar fjalë të reja nga vetë brumi i saj dhe sipas modeleve ekzistuese.

Vihet re jo vetëm përdorimi gjithnjë e më pak i prapashtesave të huaja (sidomos turke), që formojnë emra njerëzish sipas profesionit, por edhe zëvendësimi i prapashtesave të huaja në emra me temë të huaj

ose internacionale. Kështu p.sh. përdoret *seleksionuese*, në vend të *seleksioniste*.

«Pastaj stivat e kompensatos ndaheshin nga *seleksionueset* në katër kualitete» (K.L.Sh.); «Drejtuesit e këtyre brigadave morën këto ditë një iniciativë të mirë duke kryer vetë edhe dy detyra të tjera: atë të kontrollorëve së cilësisë dhe të *seleksionueses*» (Z.P., 1966, 11. 2, 3);

Stampuese në vend të *stampiste*.

«Tani ajo është edhe *stampuese* edhe shkrimëse... (Z.P. 1968, 19. 5, 3). Kishte 5 vjet që punonte si *stampuese* pëlhurash të mëndafsh-ta»... (Z. R., 1961, 13. 5, 2).

Megjithatë, zëvendësimi i fjalëve të huaja të panevojshme dhe i prapashtesave të tyre, me fjalë dhe prapashtesa shqipe, është një proces i gjatë, për të cilin mbetet akoma punë për të bërë. Kështu krahas zëvendësimit të shumë formave me -xhi/je ndeshen dhe përdoren aty-këtu fjalë si *dorezaxhije*, *mëngaxhije*, *xhëpaxhije*, *jakaxhije*³⁷, *bojaxhije* etj. që nuk këshillohen të përdoren. Me përjashtim të ndonjëres si *bojaxhije*, *bojaxheshë*, të tjerat nga sfera e ngushtë e përdorimit dhe e përhapjes në gjuhë, tregojnë se nuk kanë prirje të hyjnë në gjuhën letrare.

Edhe në prodhim aty-këtu vihet re përdorimi i disa fjalëve të huaja të panevojshme, kur është plotësisht i mundshëm zëvendësimi i tyre me emra shqip, në disa raste edhe vetë mjeshtëria e jep këtë mundësi. Quhet p.sh. *skuadruese* = punëtorja që pret pllaka mozaiku në formë katrore (K. J. Pashko — T.), në vend të *prerëse* = punëtorja që pret kallëpet e këpucëve, kostumeve etj. (N.SH.R.G. — T), ose *lapuese*, *luçiduese* = punëtorja që i shkëlqen me fërkim pllakat e mermerit ose të mozaikut (K.J. Pashko — T.), në vend të *llustruese* = punëtorja që llustron, shkëlqen mobiljet (kudo).

*

Studimi i emërimit të grave sipas profesionit, në dritën e fakteve gjuhësore të shqipes së sotme, na lejon të nxjerrim disa konkluzione të përgjithshme.

a) Rritja e emërtimeve të grave sipas profesionit në vitet e pasqirimit, pasqyron shkallën e gjerë të pjesëmarrjes së gruas në prodhimin shoqëror, si dhe në sferat drejtuese;

b) Në emërtime të grave sipas profesionit, formimet prapashtesore (sidomos ato me prapashtesën -e) mbizotërojnë pothuajse plotësisht në shqipen e sotme. Mbizotërimin e këtij tipi e shohim jo vetëm në fushën e prodhimit industrial, por edhe në fusha të tjera të jetës ku grua ja jep kontributin e saj si p.sh.: *artist-e*, *këngëtar-e*, *aktor-e*, *regjizor-e*, *arkeolog-e*, *historian-e*, *korrs-e*, *mbjellës-e*, *mësues-e*, *arësimtar-e*, *inspektor-e*, *stallier-e*, *korektor-e*, *redaktor-e*, *infermier-e*, *bibliotekar-e*, *pedagog-e*, *kujdestar-e*, *dentist-e*, *okulist-e*, *pjaniist-e*, *pastiçier-e*, *nar-kotizator-e*, *garderobist-e*, *postjer-e*, *kuzhinier-e*, *kamerier-e*, *gazetar-e*, *shkrimtar-e*, *edukator-e*, *valltar-e*, *gjqytar-e*, *piktor-e*, *skulptor-e*, *arkitekt-e*, *vreshtar-e*, *krasitës-e*, *shartues-e*, *sanitar-e* etj.

Disa prapashtesa të huaja siç është ajo sllave -icë dhe prapashtesa dialektore -cë, që kanë qenë prodhuese për një sërë emrash si: *dhas-kalicë*, *magjistrice*, *hamallicë* dhe *hollojcë*, *vajtojcë*, *gatojcë*, *fërkojcë*

37) Quhet punëtorja që qep dorezat, mëngët, xhëpat, jakat e këmishëve ose kostumeve (N.Sh.R.G.).

etj. në gjuhën e sotme shqipe e kanë humbur prodhueshmërinë e tyre. Me ndihmën e këtyre prapashtesave nuk formohen më emra të grave sipas profesionit.

c) Nga pikëpamja kuptimore, emrat e grave sipas profesionit, të formuar nga tema foljore që tregojnë procesin e punës që bën punëtorja, janë më prodhues se gjithë tipat e tjerë. Zgjerimi i prodhimit, ndarja e punës në procese të ndryshme, zbatimi i metodës zinxhir në prodhim, specializimi i punëtoreve në një hallkë të procesit të punës, kërkojnë emërtimin e saktë të punëtoreve në bazë të punës që bën. Në disa raste kur një fjalë e vetme nuk shpreh dot me përpikmëri punën që bën punëtorja, ajo saktësohet me përdorimin e emërtimeve perifrastike të ndërtuara me dy ose tre fjalë si p.sh. *qëruese mishi, përgatitëse e fletëkatodave, mbledhëse cigaresh, mbuluese çatijash, çveshëse e lëkurëve të bagëtive, shplekëse e kavove të çelikut* etj.

d) Fjalorët e deritanishëm nuk na kanë dhënë një pasqyrë të saktë dhe të plotë të emrave të njerëzve sipas profesionit. E metë e theksuar vihet re veçanërisht lidhur me emrat në gjininë femërore. Edhe «Fjalori i gjuhës shqipe» i vitit 1954 në këtë drejtim ka të meta e zbrastësi. Mbetet si detyrë e fjalorit të ardhshëm të gjuhës së sotme shqipe që këtë kategori emrash ta pasqyrojë në mënyrë sa më të plotë. Siç jepet edhe tek parimet e hartimit të fjalorit, këtu «do të përfshihen gjerësisht emërtimet profesionale që shënojnë personat sipas veprimtarisë që kryejnë në këtë ose atë degë të prodhimit shoqëror, të shkencës, të teknikës, të arteve, të administratës shtetërore, të organizatave ekonomiko-shoqërore, të institucioneve kulturore etj.


Një zgjerim të veçantë do të kenë këtu emërtimet profesionale të gjinisë femërore, të cilat, në përputhje me rritjen e madhe të rolit të gruas në jetën tonë shoqërore, do të jepen veçan, krahas atyre të gjinisë mashkullore. Kështu, fjalësi do të përfshijë, p.sh. *çelikhkrirës, vinçier-i e vinçiere-ja, frezator-i e frezatore-ja, tornitor-i e tornitore-ja, normist-i e normiste-ja, buldozerist-i, skreperist-i, mjek-u e mjeke-ja, dentist-i e dentiste-ja, bibliotekar-i e bibliotekare-ja, shitës-i e shitëse-ja, skiator-i e skiatore-ja, alpinist-i e alpiniste-ja, atlet-i e atlete-ja, brigadier-i e brigadiere-ja, llogaritar-i e llogaritare-ja, arkëtar-i e arkëtare-ja, fotograf-i e fotografe-ja, regjizor-i e regjizore-ja, endëse, tezgjahiste, mjelëse, parashutist-i e parashutiste-ja*³⁸.

e) Puna e filluar për grumbullimin, sistemimin dhe studimin e emërtimeve të grave sipas profesionit, mbetet për t'u vazhduar më tej, duke gjurmuar jo vetëm fushën e prodhimit industrial, po edhe fushat e tjera të jetës bujqësore, blegtorale, arësimore, kulturore etj., ku grua ja jep kontributin e saj për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

SHKURTIMET E PËRDORURA BRENDA NË TEKST

- G.SH. 1921, 6, 44 — «Grueja shqyptare» Shkodër, 1921, nr. 6, f. 44.
 M. 1928, 3, 77 — «E Përkohëshmjia Mësuesi» Tiranë, 1928, nr. 3, f. 77.
 D. 1929, 1, 21 — «Diturija» Tiranë, 1929, nr. 1, f. 21.
 K.P.L. 1955, 315 — Instituti i Shkencave; «Këngë popullore lirike» Tiranë, 1955, f. 315.
 G.R. 1929, 9.1, 3 — «Gazeta e Re» Tiranë, 1929, 9.1, f. 3.
 Sh.R. 1931, 1, 6 — «Shqiptarja e Re» Tiranë, 1931, nr. 1, f. 6.
 Folk. 1940, 1, 23 — «Folklorë» Shkodër, 1940, vëll. 1, f. 23.
 L. 1940, 82 — Revista «Leka» Shkodër, 1940, f. 82.

38) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»* «Studime filologjike», 1968, nr. 2, f. 65.



- Bul. I. Shk.* — «Buletin i Institutit të shkencavet»
 III, 1938, 28.9, 2 — «Illyria» 1935, 28.IX, f. 2.
J. 1937, 24, 10 — «Java» Tiranë, 1937, nr. 24, f. 10.
Rr. Sh.V.Sh. 1936, 7 — «Rregullorja e Shoqërisë Vajza shqiptare», Tiranë, 1936, f. 7.
I.A. Kyrias, 1931-32, 2 — «Institutit Arësimuer Kyrias» — Rregullore e Brendshme,
 1931-32, f. 2.
Z.P. 1967, 27.10, 2 — Zëri i Popullit, Tiranë 1967, 27.X, f. 2.
S.Sh.Sht. 1968, 57 — «Sigurimet shoqërore shtetërore», Tiranë, 1968, f. 57.
Y. 1967, 10, 34 — Ylli, Tiranë 1967, nr. 10, f. 34.
P. 1958, 25.2, 2 — Gazeta «Puna» Tiranë, 1958, 25.II, f. 2.
S. Jasa, S.F., 1963, 51 — Skënder Jasa: «Sirenat e fabrikave» Tiranë, 1963, f. 51.
Dr. 1968, 18.2, 3 — Gazeta «Drita», Tiranë, 1968, 18.II, f. 3
N. 1967, 6, 21 — Rev. «Nëndori» Tiranë, 1967, nr. 6, f. 21.
Z.R. 1962, 12.9. — «Zëri i Rinisë», Tiranë, 1962, 12.9.
Sh. 1967, 28.10, 1 — Gazeta «Shkumbini» Elbasan, 1967, 28.X, f. 1.
M. 1966, 10.9, 3 — Gazeta «Mësuesi» Tiranë, 1966, 10.IX, f. 3.
B. 1948, 19.5, 3 — Gazeta «Bashkimi» Tiranë, 1948, 19.V, f. 3.
A.A.T. 1962, 182 — A. Abuzov, Tanja, Tiranë, 1962, f. 182.
K.L.Sh. — Kartoteka e leksikut të shqipes
B.P.USh., 1931, 1.11, 267 — Buletini dhe e përkohëshmjia ushtarake Vj.I nr. 6, I.XI,
 1931, f. 267.
K.m. — T — Kombinati i mishit, Tiranë.
K. Mao Ce Dun — B — Kombinati Mao Ce Dun — Berat
K.J. Pashko — T. — Kombinati Josif Pashko — Tiranë
Nish Q. — T — Nish qelqi — Tiranë
N.SH.R.G. — T. — Ndërmarrja shtetërore e rrobave të gatshme — Tiranë.
F.b. — T. — Fabrika e bukës — Tiranë
F.k. — T. — Fabrika e këpucëve — Tiranë
Nish TM — Sh — Nish Tisazhmëndafshi — Shkodër
F.D. — Sh.D. — Fermentimi i duhanit — Shkodër, Durrës
F.C. — SH.D. — Fabrika e cigareve — Shkodër-Durrës.
U.T. — T — Uzina Tirana — Tiranë
F.L. — Sh. — Fabrika e letrës — Shkodër
K.U. — T. — Kombinati ushqimor — Tiranë
Nish G. — D — Nish Goma-Durrës.

P.S. Me këto shkurtime janë dhënë edhe data ose numra të tjerë të po këtyre organeve, duke ndjekur po atë renditje (vendi i botimit, viti, data ose numri, muaji dhe faqja).

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LES NOUVELLES DENOMINATIONS DES FEMMES D'APRES LES PROFESSIONS DANS LE DOMAINE DE LA PRODUCTION INDUSTRIELLE APRES LA LIBERATION

L'auteur fait observer que les dénominations des individus en général d'après la profession exercée et la tâche qu'ils ont constitué en albanais contemporain une vaste couche. Ont du poids dans ce domaine surtout les nouvelles dénominations des femmes, ce qui est un indice de leur ample participation à la production sociale et aux sphères dirigeantes. Les nouvelles demandes soulevées par le développement de notre société après la libération ont été satisfaites par la langue au moyen de son enrichissement par des mots et des expressions nouvelles.

Les lourdes conditions économiques, politiques et sociales dans lesquelles se trouvait notre pays avant la libération, et naturellement le faible développement des forces productives n'ont pas permis l'ample participation des gens, et notamment de la femme à la production sociale. L'activité de la femme se bornait au ménage et à quelque cas de fête ou de deuil. Cela est illustré aussi par les dénominations qu'on

trouve dans les dictionnaires bilingues et la presse de l'époque, où l'on trouve des dénominations telles que: gatojcë «boulangère», hollojcë «ouvrière qui prépare la pâtisserie feuilletée», ferkojcë «frictionneuse», vajtojcë «pleureuse», shërbëtore «servante», fallxheshë «devineuse», etc. On n'a pas, dans le vrai sens du mot, des dénominations de professions, mais de celles pour des travaux particuliers que faisaient des femmes aux gages.

Pourtant, on a aussi des dénominations qui marquent une profession: hamalle ou hamallicë «porteuse, femme porte-faix», mësuëse «institutrice», modiste «modiste», shërbëtore «femme de service» etc.

Jusqu'à la libération du pays les dénominations des femmes selon la profession ne constituaient pas, pourtant, une véritable couche lexicale complète: dans le domaine de la production industrielle il ne pouvait être question presque du tout de dénominations de femmes. Néanmoins, même dans ce petit nombre nous pouvons trouver les types les plus productifs de la formation des mots. Le principal chemin est celui à suffixation, sur la base des noms masculins, à l'aide des suffixes -e et -eshë: mjelës-e «trayeur, euse», shëronjës-e «guérisseur, euse», shërbëtor-e «servant-e», mësuës-e «instituteur, trice», bari-bareshë «berger, ère», mjek-mjekeshë «docteur, toresse».

Dans les années après la libération, les nouvelles conditions sociales donnèrent la possibilité à la femme de participer amplement à la production sociale. C'est ainsi que se fait jour aussi la nécessité de dénommer les nouvelles tâches et fonctions qu'elle prend dans la société. Ce processus ouvre le chemin à l'enrichissement non seulement quantitatif, mais aussi à celui des modifications qualitatives. Tombent en désuétude des notions qui se rattachent à l'ancien système: vajtojcë, fallçore, etc., et assument une nouvelle acception des noms comme: endëse «tisserande», etc.

L'auteur fait observer aussi que dans le Dictionnaire de l'albanais de 1954 on n'a pas inséré des noms comme agronome «agronome femme», brigadiere «brigadière», elektrikiste «électricienne», frezatore «ouvrière fraiseuse», makiniste «ouvrière machiniste», traktoriste «ouvrière tractoriste», etc., qui pourtant figuraient dans la presse de l'époque.

Deux sont les principaux chemins de la formation de ces mots en albanais: a) Les formations suffixales; b) les formations indépendantes (dénomination au seul féminin).

a) Pour les formations suffixées ont leur place les noms féminins formés sur la base des masculins, à l'aide des suffixes -e et -eshë. Les formations à l'aide de l'-e forment actuellement le plus grand nombre de ces dénominations et la base des formations futures pour de nouveaux noms. Ce suffixe se rattache aux noms masculins à thème dérivé comme tjerr-ës-e «fileuse», gdhend-ës-e «graveuse», skalit-ës-e «ouvrière sculpteur», pres-tar-e «tailleuse», këpuçë-tar-e «cordonnrière», etc. ou bien à l'aide de composés: leshpunues-e «tisseuse de laine», rrobalarës-e «laveuse», libralidhës-e «relieuse», kryeinxhinier-e «femme ingénieur-en-chef», etc.

Le suffixe -eshë est moins productif. Habituellement il est adjoint aux noms masculins à thème simple: bari-bareshë «berger, ère», bujk-bujkeshë «laboureur, euse», poet-poeteshë «poète, tesse».

b) Des formations indépendantes (dénominations au seul féminin) ont pris naissance sur des professions qui sont du seul apanage des

femmes: mjelëse «trayeuse», tjerrëse «tisseuse», mami «sagefemme», etc.

Plus loin, l'auteur analyse en profondeur le classement fait à l'aide de ces types et de ces principaux moyens de formation des mots par le sens de ces noms. Le plus grand groupe de ces noms est formé actuellement par ceux qui au point de vue sémantique se rapportent aux procédés de travail que fait l'ouvrière. La productivité de ce type est en rapports avec quelques facteurs comme l'extension de la production, la mécanisation des procédés de travail et la spécialisation dans un procédé. Ainsi on a endëse «tisserande», gdhendëse «graveuse», qendistare «brodeuse», tjerrëse «tisseuse», etc.

À la deuxième place viennent les dénominations qui se rapportent à la machine: frezatore «ouvrière fraiseuse», kombajnere «conductrice de moissonneuse-batteuse», linotipiste «ouvrière de linotype», motoriste «ouvrière préposée au moteur, traktoriste «ouvrière tractoriste», vinçiere «ouvrière des grues», etc.

À la troisième place viennent les dénominations d'après l'objet du travail: këpucare «cordonnière», etc.

Dans les autres places viennent ensuite les dénominations d'après la matériel manipulé, betoniste «ouvrière de bétonnière»; d'après l'instrument: zdrukthëtare «ouvrière raboteuse»; d'après le lieu de travail arkëtare «caissière», farmacist «pharmacienne»; ainsi que des dénominations différentes qui désignent la femme d'après son poste de direction ou d'administration: kryeinxhinierë «femme ingénieur-en-chef», normiste «normiste», mjeshtrë «femme maître de travail», ministër «femme ministre», drejtoreshë «directrice», etc.

Plus loin, l'auteur procède à un classement de ces noms, en les considérant dans la sphère de leur diffusion dans la langue littéraire. Une partie de ces noms ont passé, au point de vue de leur usage et de leur diffusion, du lexique étroit professionnel à la langue littéraire: endëse, këpucare, argjendare, gdhendëse, rrobaqepëse, hekurpunuese, tornitore, saldatore, frezatore, montatore, etc.

D'autres noms qui représentent des professions nouvelles n'ont pas encore passé à la langue littéraire: bluese «ouvrière broyeuse», drethëse «ouvrière à tresser», dhënëse «fournisseuse», matëse «ouvrière mesureuse», qepëse «couseuse», etc.

L'auteur insiste aussi sur le fait de substituer les formations à suffixes étrangers par des suffixes albanais. Quoique l'on ait substitué plusieurs de ceux-ci, on a dans la production une certaine persistance du suffixe turc -xhi/je: dorezaxhije «femme qui confectionne des gants», mëngaxhije «femme qui prépare les manches», xhepaxhije «femme qui prépare les poches», etc.

L'auteur termine son article en insistant que le chemin de la formation des dénominations des femmes d'après la profession est celui suffixal, dont la place principale va aux dérivés par l'adjonction du suffixe -e

Il reste au Dictionnaire de l'albanais contemporain de faire refléter plus amplement cette catégorie de noms, en lui donnant la place qu'il leur revient.